



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**

**PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR.61, PARAQITUR NË KQZ NË DATËN 11.07.2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 12.07.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** Z. Ylber Gjeta .

**OBJEKT:** Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore Nr.61, datë 11.07.2019, të paraqitur nga kërkuar Z. Ylber Gjeta, kandidat për Kryetar Bashkia Kamëz, me objekt: "Shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në Bashkinë Kamëz, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019."

**BAZË LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa "a", neni 129, pika 1, 3, germa (b), neni 126, pika 2, neni 130 gëma b dhe c, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

**V Ë R E N:**

Kërkuar Z. Ylber Gjeta ka depozituar pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në Regjistrin e Ankimeve Zgjedhore, me Nr.61 regj, datë 11.07.2019 me relator znj. Edlira Jorgaqi.

Në lidhje me kërkesën ankimore nr. 61 të datës 11.07.2019 nëpërmjet të cilës Z. Ylber Gjeta, kandidat për Kryetar Bashkia Kamëz kërkon shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në Bashkinë



Kamëz, duke kundërshtuar vendimin nr. 953 datë 06.07.2019 të KQZ-së, u konstatua paraqitja e kësaj kërkesë jashtë afatit ligjor të orarit zyrtar.

KQZ, referuar nenit 129 të Kodit Zgjedhor bën verifikimin paraprak të kërkesës ankimore, në lidhje me elementet e formës të përcaktuara në nenin 126 të Kodit Zgjedhor si dhe verifikon elementet e mëposhtme të përcaktuara në nenin 130 të Kodit Zgjedhor:

- a) kompetencën e KQZ-së për shqyrtimin e ankimit;
- b) legjitimitimin e ankuesit; dhe
- c) respektimin e afateve ligjore për ankimin.

Në datë 12.07.2019 ora 12.00, pas relatimit të Znj. Edlira Jorgaqi, u konstatua se kërkesa ankimore me nr. 61 me objekt "Për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në Bashkinë Kamëz", ankues është kandidati për Kryetar Bashkie, Z. Ylber Gjeta. Referuar nenit 124 paragrafi 1 ku parashikohet shprehimisht se: "Çdo parti politike pjesëtare ose jo e një koalicioni dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit kanë të drejtë të ankohen në KQZ kundër vendimeve të KZAZ-së". Në këtë rast referuar nenit 124, pika 4, ankimuesi kandidat për Kryetar Bashkie nuk legjitimohet të bëjë ankesë në KQZ. Kërkesës ankimore i mungon elementi i legjitimitimit të parashikuar në germën b të nenit 130 të Kodit Zgjedhor.

Përsa i përket parashikimeve të nenit 130 germa c, kërkesa ankimore është paraqitur në KQZ në datën 11.07.2019 brenda afatit ligjor ditor të parashikuar nga KQZ -ja, por u depozitua në orën 21:00, pra jashtë afatit të orarit zyrtar.

Depozitimi i ankimit jashtë orarit zyrtar, e bën ankimin të mos plotësojë elementët e parashikuara në nenin 130 germa c të Kodit Zgjedhor. Në këto kushte kërkesa ankimore nuk i plotëson elementët e parashikuara në nenin 130 germa b dhe c të Kodit Zgjedhor, elementë që lidhen me legjitimitetin dhe afatin.

Për sa më sipër në mbështetje të nenit 129 pika 3, germa (b) të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, kërkesa ankimore nuk duhet të pranohet për shqyrtim.

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 21, pika 1, nenin 126, pika 2, nenin 129, pika 3, germa (b) të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.



## **V E N D O S I:**

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr.61, datë 11.07.2019, të paraqitur nga Z.Ylber Gjeta.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv.Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>

